Mbështesim zhvillimin e kompetencave transkulturore për profesionistët e shëndetit në Ballkanin perëndimor.

Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans, TCCWB

SHKOLLË DIMËRORE

9-13 Shkurt 2026
Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër
Albania



Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union

Skenar simulimi klinik- 1



- **Tema e skenarit**

Marrja në konsideratë e dallimeve kulturore në kujdesin emergjent për një turiste italiane në Shqipëri

- **Konteksti**

Një çift turistësh italianë, të dy 54 vjeç, u sollën me ambulancë në pavionin e urgjencës së spitalit rajonal të Gjirokastrës, në orën 7 të mbrëmjes.

Pacientja femër nuk është e vetëdijshme dhe ka shenja klinike të shokut hemorragjik. Pacienti mashkull nuk ka trauma të dukshme, është i vetëdijshëm dhe i thotë stafit se zonja është Dëshmitare e Jehovait dhe nuk pranon transfuzione gjaku.

Ata pësuan një aksident të rëndë me makinë, gjatë të cilit një pjesë metalike e makinës së aksidentuar i ka prerë arterien karotide të djathtë gruas dhe shkaktoi një hemorragji masive që menjëherë pas mbërritjes në spital çoi në arrest kardiak për shkak të shokut hemorragjik.

Skenar simulimi klinik- 1



- Stafi i spitalit flet mirë italisht.
- Turisti mashkull flet vetëm disa fjalë në shqip dhe ndihet rehat vetëm në gjuhën e tij amtare

- Infermierët do të duhet të bëjnë vlerësimin klinik të pacientes femër, ndërkohë të komunikojnë me turistin mashkull dhe të ofrojnë ndihmën e parë për menaxhimin e arrestit kardiak.

Skenar simulimi klinik- 1



- **Diskutim**
- PËRSHKRIMI dhe ndjenjat:

Çfarë lloj ndjenjash ngjalli simulimi?

Cilat janë mendimet tuaja për mënyrën se si e menaxhuat situatën?

Çfarë mësuat prej simulimit?

Çfarë ishte e vështirë për tu arritur?

- **VLERËSIMI dhe ANALIZA**:

Për pjesëmarrësit në simulim:

Ku patët sukses?

Çfarë lloj çështjesh kulturore dolën?

Cilat ndërhyrje infermierore ishin të nevojshme?

Çfarë do të bënit ndryshe? Pse?

Skenar simulimi klinik- 1



- **Për vëzhguesit**:
- Çfarë bënë mirë?
- Çfarë mund të ishte bërë më mirë?

- **PËRFUNDIME DHE ZBATIMI NË PRAKTIKË**
- Çfarë mund të mësohet nga simulimi për një situatë të ngjashme në jetën reale?
- Si do ta zbatoni atë që keni mësuar?